

FJALA E DEPUTETIT FLAMUR NOKA

E ENJTE 9 QERSHOR 2022

Dëgjo, se po flas unë! Ti, zonjë, duhet të dish një gjë: në këtë foltore, në këtë sallë nga shefi yt, nga Kryeministri juaj janë dëgjuar në këta 9 vjet pafund shpifje, sharje, fyerje për opozitën, për individë të veçantë në opozitë, për popullin opozitar dhe ti, zonjë, buzëqeshje, të shkonte buza vesh më vesh. Pse nuk t'i vriste veshi ato fjalë të rënda, kurrë nuk t'i vriste veshi?! Sepse kënaqeshe, sepse shefi yt ishte i lumtur, por nuk është faji as i Mond Spahos dhe as i Partisë Demokratike pse ju të gjithë lumturoheni kur ai i përdor të gjitha, i përdor gojarisht dhe i përdor edhe ndryshe; ju kënaqeshit, ndërkohë që çdokush në këtë vend e konsideronte keqpërdorim të fjalorit nga ana e Kryeministrit.

Tani me urdhër partie... Ju kështu jeni mësuar; nuk ju vë faj, se ju kështu jeni rritur, jeni mësuar dhe jeni edukuar me urdhra partie. Kështu që nuk shqetësohemi, as zoti Mond Spaho nuk shqetësohet fare për këto përralla që thoni ju. Sikundër e dimë që edhe për këtë akt normativ, që po diskutojmë sot, ju nuk keni asnjë shqetësim pse opozita, pse Partia Demokratike, pse deputetët e saj vijnë këtu dhe u thonë që çmimet janë në stratosferë. Ju me këto rritje nuk keni të krahasuar me asnjë vend tjetër jo në rajon, por as në Europë dhe askund. Çmimi i naftës është më i shtrenjtë se gjithkund. Pse? Sepse qeveria juaj nuk do t'ia dijë që të ndërhyjë; as se duhet hequr akciza për çmimet; as se duhet hequr TVSH-ja, siç kanë ndërhyrë qeveritë e tjera të rajonit, si Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Serbia e sivëllait të këtij.

Të gjithë kanë ndërhyrë, por ju nuk doni t'ia dini. Ju keni një parim: të dhjamoseni, të vidheni, të pasuroheni, shqiptarët të vdesin, të lëvizin këmbën atje; as nuk jua ndien. Pse e keni ju këtë? Sepse parimi i shefit tuaj dhe juaji është: le të varfërohen, le ta lëvizin, le ta shtrijnë këmbën aty. Pse? Kur të vijë dita e zgjedhjeve, ne i blejmë. Nuk na kërcet neve për votën lirë; ne i blejmë. Ne vjedhim që t'i blejmë; i blejmë që t'i sundojmë; i sundojmë që t'i poshtërojmë; i poshtërojmë që përsëri t'i blejmë. Këto janë parimet tuaja. Ndaj ky nuk është shqetësim fare

për ju. Ne e dimë këtë punë dhe çfarë ndodh tani? E dini cili është shqetësimi i opozitës, shqetësimi i demokratëve në këtë vend, i opozitarëve në këtë vend?

Përpos këtyre maskaradave, që i keni bërë të rrugës t'iu bëni, ka nja tre vjet që ju keni marrë një stil të bukur: të keqpërdorni edhe opozitën, të emëroni edhe opozitën, të caktoni se cila është opozita, pavarësisht se demokratët e kanë përcaktuar se cila është opozita. Ju përdorët opozitën e “kërpëratave” për të vazhduar, për të votuar, për të miratuar dhe për të kaluar çdo bastardllëk që i keni bërë këtij vendi. Ju e bëtë. Tani çfarë ndodh? Ju na keni gjetur një çerek opozitë, pra nga opozita e “kërpëratave”, tek opozita e “bravave”, dhe merreni me Enkin, me Gazin, me Jorin e me tjetrin. I merrni këtu, i keqpërdorni, i fshini, i hidhni, i lani, i fusni përsëri, i ricikloni, i fusni përsëri në përdorim për t'ju shërbyer që ju të vidhni, të pasuroheni, që ju ta shtypni këtë popull, ta keqtrajtoni këtë popull. Këtë mision keni ju.

Pra, misioni juaj është të varroset demokracia në këtë vend, të varroset pluralizmi, të emëroni gjithçka. Pasi keni kapur të gjitha pushtetet, e vetmja gjë, që ju kishte ngelur pa kapur, është opozita. Ja ky i keni pengjet; shikojini aty, i keni kapur, ju shërbejnë, ju servilosen, i urdhëroni për çfarë të doni, por harrojeni, opozitë këtij populli nuk i emëroni dot; opozitë nuk caktoni dot, sepse e cakton vota e demokratëve, jo juaja, duhet ta keni të qartë. Sot këtu na keni sjellë për të miratuar dy komisione, që jua kanë propozuar Enki me Gazin dhe me Joridën: komision për reformën zgjedhore dhe komision për reformën territoriale. More, kjo opozitë a i ka 59 deputetë më 25 prill? A e dini që i ka? Por me kë jeni konsultuar, me 3-4 ushtarët tuaj, me sejmënët tuaj i bëni këto?

A e dini ju që Enki, Gazi dhe Jorka nuk dalin dot nga shtëpia, jo më të shkojnë në elektorat që të marrin mendime, të pyesin dhe të konsultohen për reformën zgjedhore dhe reformën territoriale? A e dini se nuk ua hap derën askush, përveçse te zyra, që u keni dhënë ju në Kuvend dhe te shtëpia e tyre? Ju i keni caktuar opozitë dhe bëni çfarë doni me ta. A e dini ju se i gjithë populli opozitar nuk është për pazar me ju, pavarësisht se këta bëjnë pazar me ju?! Ku ju çon mushka me këtë histori?! E patë a e bëtë reformën; a e bëtë një komision hetimor për inceneratorët? Ku ishte rezultati? U la Edi Rama, iu bë lavazh; iu bë lavazh Arben Ahmetajt; iu

zbardh fytyra. A ishte komisioni i zgjedhjeve, i vjedhjes së votave me 25 prill, sepse ishin këta që u caktuan bashkë me ne, që ju quajtnë regjim që vodhët zgjedhjet, manipuluat?

Taulant, ku shkoi komisioni i reformës zgjedhore? A mos e ndatë kokë me kokë këtë punë, një në atë botë dhe një në këtë botë të kalbet në burg, ju të vazhdoni të dy në paqe dhe në qetësi, sepse kështu më duket se u la? A u la kështu, pra që njëri të kalbet i vdekur në varr, tjetri të kalbet i gjallë në burg dhe ju të jeni në rregull? A është pazar ky, apo jo? A e dinë demokratët dhe shqiptarët se cili është regjimi dhe çfarë ndodhi që u vodhën votat dhe u manipuluan votat, që e kemi thënë këtu të gjithë këtej me të madhe më 25 prill? Ku shkoi ai komision? A ka ndonjë shqiptar që e di se cili është rezultati i atij komisioni që sot po na ngrihet një komision tjetër? Çfarë janë këto komisione që i ngrini ju?

Komisionet ngrihen për t'ju shërbyer juve, Edi Ramës dhe regjimit. Çfarë lidhje kanë Enki, Gazi dhe Jorka me reformën territoriale dhe zgjedhore? Asnjë lidhje. Jua them unë që dalin vetëm nga shtëpia në zyrë dhe nga zyra në shtëpi. Ku e kanë elektoratin? Le të shkojnë. Në cilën zonë zgjedhore shkelin këta? Ku janë këta, që ju keni vendosur t'i quani pjesë esenciale të opozitës për reformën territoriale dhe zgjedhore? Po Partia Demokratike a ka marrë vota në Jug? Ka marrë. Cili është përfaqësuesi në këtë reformë? Asnjë. Po bëhet një reformë, por qarku i Elbasanit nuk ka asnjë përfaqësues. Pse? Sepse nuk duan këta. E ka tmerr Gazi Elbasanin, i bie të fiktë; vetëm se ia ka kuruar plagët Taulanti, se i bie të fiktë kur ia përmend.

I bie të fikët; nuk do që të jetojë. Tani ku është kjo histori? Ku është qarku i Vlorës, një nga qarqet më të mëdha të këtij vendi? Kush do ta bëjë diskutimin për reformën territoriale për atë qark? Ku është qarku i Beratit? Çfarë janë këto? Thjesht pazare. Pazare në kurriz të kujt? Jo në kurrizin tuaj, sepse ju vetëm përfitoni, madje shumica prej jush nuk ka lidhje me përfitimin, por kanë këta mbrapa. Këtu ka shërbëtorë; këtu ka opozitë fake; këtu opozitë të emëruar. Prandaj bëhen pazaret, duke i emëruar, sepse nuk kanë votë. Të dalin dhe ta provojnë që janë përfaqësues të Partisë Demokratike, por jo ti emëroni. Gaz, dil edhe ti provoje! Kjo është çështja. Atëherë, i morët të gjitha institucionet, tani doni të rrëmbeni edhe atë pjesë të opozitës, doni të ktheni monizmin?! Harrojeni! Ju mund të mendoni çfarë të doni me disa marioneta këtu, por demokratët...